

## PËRGJEGJËSIA NDËRKOMBËTARE NË LIDHJE ME MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Luljeta KODRA\*

**Abstrakt:** Mbrojtja e të drejtave të njeriut është një çështje ndërkombëtare. Komuniteti ndërkombëtar duhet të përdorë të gjitha mënyrat e mundshme për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe për të parandaluar shkelje masive dhe sistematike të këtyre të drejtave që mund të përbëjnë rrezik për paqen. Një nga mënyrat që komuniteti ndërkombëtar ka përdorur për këtë qëllim, në vendet ku qeveria ka qenë e paaftë të ndalojë shkeljet e rënda të të drejtave njerëzore ose ajo vetë ka qenë përgjegjëse për shkeljen e tyre, ka qenë edhe ndërhyrja humanitare. Por, që ndërhyrja humanitare të jetë efektive dhe të përdoret thjesht për motive humanitare, pa abuzime nga ana e shteteve më të fuqishme, ajo duhet vendosur brenda një kornize ligjore. Arritja e një konsensusi ndërkombëtar, për një bazë ligjore të ndërhyrjeve humanitare, do të lehtësonte mundësinë e komunitetit ndërkombëtar për të vepruar në situata krizash humanitare dhe do të shmangte çdo mundësi të përdorimit të ndërhyrjeve humanitare për interesa vetjake të shteteve, duke përdorur arsyet humanitare si justifikim.

**Fjalët çelës:** Ndërhyrje humanitare, komunitet ndërkombëtar, krizë humanitare, sistem ndërkombëtar sigurie, sovranitet shtetëror, të drejtat e njeriut.

### 1. Hyrje

Respektimi i të drejtave të njeriut nga shteti konsiderohet nga e drejta ndërkombëtare e sotme si kusht për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Mbrojtja e të drejtave njerëzore nuk është një çështje që i përket ekskluzivisht juridiksionit të brendshëm të shteteve. Këshilli i Sigurimit dhe Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara janë organet që kanë të drejtë të veprojnë ose të autorizojnë veprime në raste konfliktesh të armatosura, që përfshijnë shkelje masive të të drejtave njerëzore. Por, vitet e fundit ndërhyrje humanitare janë ndërmarrë edhe nga shtete të veçanta, ose organizata rajonale pa marrë më parë autorizimin e Këshillit të Sigurimit.<sup>1</sup> Qëllimi i këtij punimi është që të diskutojë mbi mundësinë e ndërhyrjes në mbrojtje të të drejtave njerëzore jashtë sistemit të Kombeve të Bashkuara, në rastet kur Këshilli i Sigurimit nuk është në gjendje të veprojë, për shkak të mungesës së vullnetit politik të anëtarëve të tij, në mënyrë që t'i jepet fund katastrofave humanitare, të krijohen kushtet në të cilat njerëzit të mund të

---

\* Pedagoge e të drejtës ndërkombëtare, Akademia Ushtarake 'Skënderbej', Tiranë.

<sup>1</sup> Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999 ndodhi pa autorizimin eksplícit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Shih ndër të tjera Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, (2000) Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Intervention, and International Citizenship.

jetojnë të qetë dhe të sigurohet drejtësi për viktimat. Për të arritur këtë qëllim është studiuar rasti më tipik i ndërhyrjes humanitare në mbrojtje të të drejtave njerëzore, pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit, rasti i Kosovës.

## 2. Rëndësia e respektimit të drejtave të njeriut

Pas Luftës së Dytë Botërore (L2B) promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut u shpall si një prej qëllimeve primare të Kombeve të Bashkuara, që do të kontribuonte në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Anëtarët e Kombeve të Bashkuara u zotuan se do të ndërmerrnin veprime në bashkëpunim me organizatën, për të mbështetur respektimin e përgjithshëm të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë.<sup>2</sup> Në këtë mënyrë ndryshoi koncepti tradicional për të drejtat njerëzore. Respektimi i përgjithshëm i këtyre të drejtave u bë një çështje ndërkombëtare. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, e miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948, e cila vendosi themelin e standardeve të drejtave ndërkombëtare të njeriut, bëri një hap përpara duke e konsideruar respektimin e të drejtave njerëzore si të nevojshëm për ruajtjen e paqes ndërkombëtare.

Përgjegjësia për mbrojtjen e të drejtave njerëzore i takon në radhë të parë çdo shteti sovran.<sup>3</sup> Siç parashikohet në nenin 138 të Dokumentit Përfundimtar të Samitit Botëror të vitit 2005, “Çdo shtet ka përgjegjësi të mbrojtë popullsinë e tij nga genocidi, krimet e luftës, spastrimi etnik dhe krimet kundër njerëzimit.” Por, kur një popullsi civile vuan nga abuzimet serioze me të drejtat njerëzore dhe qeveria është e paaftë t’i ndalojë këto abuzime, ose ajo vetë është shkaktare e tyre, atëherë kjo përgjegjësi i kalon komunitetit ndërkombëtar.<sup>4</sup> Komuniteti ndërkombëtar nuk mund të qëndrojë indiferent kur shkelen të drejtat njerëzore brenda një shteti. Ai duhet të angazhohet në mbrojtjen e këtyre të drejtave, pavarësisht parimit të sovranitetit shtetëror.

Megjithëse sovraniteti dhe mosndërhyrja janë parime bazë të marrëdhënieve ndërkombëtare,<sup>4</sup> kur ndodhin abuzime serioze me të drejtat njerëzore brenda një shteti, vëmendja duhet drejtuar tek përgjegjësia ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave individuale. Shtetet nuk mund të lejohen të fshihen pas konceptit të sovranitetit dhe të shkelin në mënyrë flagrante dhe masive të drejtat e qytetarëve të tyre,<sup>5</sup> sepse kjo do të nënkuptonte dështimin e komunitetit ndërkombëtar në mbrojtjen e të drejtave njerëzore të gjithëpranuara.

<sup>2</sup> Charter of the United Nations, June 26, 1945, entered into force October 24, 1945.

<sup>3</sup> Michelle Maiese, (2004) Human Rights Protection.

<sup>4</sup> Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention. Global Dialogue, Vol.7, Num. 1-2, Winter/Spring 2005.

<sup>5</sup> Jonathan I. Charney, Anticipatory Humanitarian Intervention in Kosovo. Vanderbilt Journal of Transnational Law, November 1999.

Është diskutuar shumë mbi faktin se zhvillimi i të drejtave ndërkombëtare njerëzore dhe i të drejtës ndërkombëtare humanitare, ka ndryshuar konceptin e sovranitetit shtetëror.<sup>6</sup> Dokumenti “Një axhendë për paqen” i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Butros Butros Gali, që në vitin 1992, ka konfirmuar të drejtën e Kombeve të Bashkuara për të ndërhyrë në një shtet, sipas Kapitullit VII të Kartës, në emër të të drejtave të qytetarëve. Kjo axhendë ishte parathënia e faktit që “koha e sovranitetit absolut dhe ekskluziv ka kaluar”.<sup>7</sup>

### 3. E drejta e Këshillit të Sigurimit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Shkelja e të drejtave të njeriut ka qenë shkak i shumë konflikteve të brendshme dhe shoqëruet i këtyre konflikteve.<sup>8</sup> Kombet e Bashkuara shpeshherë kanë arritur në përfundimin se shkeljet e mëdha dhe sistematike të të drejtave njerëzore përbëjnë kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.<sup>9</sup> Në disa raste abuzimi me të drejtat e popullsisë ka qenë në nivele të tilla sa që është gjykuar i nevojshëm përdorimi i forcës si mundësi e vetme për t’i ndaluar këto abuzime. E drejta për përdorimin e forcës, kur vërehen shkelje të të drejtave të njeriut brenda një shteti që mund të përbëjnë kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, i takon Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.<sup>10</sup>

Këshilli i Sigurimit mund të ushtrojë të drejtën e tij për ndërhyrje nëpërmjet dërgimit të trupave paqeruajtëse (të njohura edhe si helmetat blu), duke mbajtur komandën operacionale, ose mund të autorizojë një palë të tretë që të ndërhyjë.<sup>11</sup> Kjo e drejtë e Këshillit të Sigurimit për të autorizuar përdorimin e forcës për qëllime humanitare në shtetet sovraane, bazuar në pushtetet e Kapitullit VII të Kartës, që përfshijnë: përdorimin e forcës në situata në të cilat Këshilli ka vendosur “ekzistencën e ndonjë kërcënimi për paqen, shkeljen e paqes ose akt agresioni”, është e njohur dhe e pranuar nga komuniteti ndërkombëtar.<sup>12</sup> Pas Luftës së Ftohtë, Këshilli i Sigurimit në fakt ka autorizuar përdorimin e forcës nëpërmjet disa rezolutave. Këto rezoluta kanë zgjeruar në njëfarë mënyre përkufizimin e “kërcënimit për paqe dhe siguri ndërkombëtare”.<sup>13</sup>

<sup>6</sup> F. J. Leon Diaz, (2002) Humanitarian Intervention Issues.

<sup>7</sup> Hugo Slim, (June 2000) Military humanitarianism and the new peace keeping. An agenda for peace?

<sup>8</sup> Michelle Maiese, (2003) Human Rights Violations.

<sup>9</sup> Stefan Kirchner, The Human Rights Dimensions of International Peace and Security: Humanitarian Intervention after 9/11. Journal of Humanitarian Assistance 25 October 2004.

<sup>10</sup> Oliver Corten, Humanitarian intervention: a controversial right, June 1999.

<sup>11</sup> Hannes Peltonen, Right and Responsibility, What Kind of Right is the Right of Humanitarian Intervention? EUI Working Papers SPS No. 2006/03.

<sup>12</sup> Larry Minear, Ted van Baarda, and Marc Sommers, NATO and Humanitarian Action in the Kosovo Crisis. Watson Institute 2000.

<sup>13</sup> Penelope C. Simons, (2000) Humanitarian Intervention: A Review of Literature. The Ploughshares Monitor. December 2000, volume 21, No.4.

Praktika e ndjekur nga Këshilli i Sigurimit, pas Luftës së Ftohtë për t'i konsideruar konfliktet e brendshme dhe shkeljet e të drejtave të njeriut si bazë për ndërhyrje ndërkombëtare, tregon se respektimi i sovranitetit të një shteti kushtëzohet nga fakti se sa ky shtet i respekton të drejtat e qytetarëve të tij.<sup>14</sup> Megjithatë, Këshilli i Sigurimit shpesh është penguar në realizimin e qëllimit të tij nga mungesa e vullnetit politik të anëtarëve të tij të përhershëm, të cilët kanë përdorur të drejtën e vetos edhe në situata krizash të rënda humanitare. Çështja e vullnetit politik ka qenë tragjike e evidente në krizën e Ruandës dhe Kosovës. Përsa i përket Ruandës, Kombet e Bashkuara kishin dijeni se një genocid po planifikohej, por ky informacion duket sikur humbi në zingjirin e burokracisë.<sup>15</sup> Në fillim të genocidit, pas vrasjes së presidentit të Ruandës dhe atij të Burundit, në 6 prill 1994, komuniteti ndërkombëtar ndërmori pak veprime për të ndaluar përkeqësimin e situatës.

Në krizën e Kosovës, për shkak të mungesës së vullnetit politik, reagimi i Këshillit të Sigurimit ishte shumë i dobët, po të kihen parasysh krimet e rënda të kryera në kurriz të shqiptarëve etnikë në Kosovë, nga shkurti 1998 deri në mars 1999. Ndërsa ndërhyrja humanitare e aprovuar nga Kombet e Bashkuara konsiderohet përgjithësisht si e ligjshme meqë autorizohet nga një organ ndërkombëtar përfaqësues, ndërhyrjet e ndërmarrë pa autorizimin e Këshillit të Sigurimit kanë qenë në qendër të shumë debateve. Dihet që Karta e Kombeve të Bashkuara nuk përjashton mundësinë e veprimit të organizatave rajonale në ruajtjen e paqes dhe sigurimit ndërkombëtar. Sipas nenit 53 të Kartës, organizatat rajonale mund të ndërmarrin aksione të zbatimit të paqes, por duke marrë më parë autorizimin e Këshillit të Sigurimit.<sup>16</sup>

Pa këtë autorizim asnjë aksion force nuk mund të ndërmerret nga organizatat rajonale. Mendimi i shumë studiuesve është që ndërhyrjet e ndërmarrë jashtë sistemit të Kombeve të Bashkuara janë të paligjshme, sepse dëmtojnë rregullin ligjor ndërkombëtar që mbron të drejtat e shteteve. Çështja më e debatueshme në këtë drejtim ka qenë ajo e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë. Por, në qoftë se pranojmë tezën e paligjshmërisë së ndërhyrjes së paautorizuar nga Këshilli i Sigurimit, duke u bazuar në interpretime statike të konceptit të sovranitetit shtetëror dhe duke u interesuar vetëm për germën e dispozitës juridike, pa marrë parasysh frymën e përgjithshme të drejtësisë, si do t'i përgjigjeshim realiteteve tragjike që imponojnë ndërhyrjen? Si do t'i përgjigjeshim katastrofave humanitare që u shpalosën në Bosnjë, Ruanda, Kosovë dhe barbarizmave që u kryen atje në kundërshtim me çdo parim të sjelljes njerëzore?

<sup>14</sup> F. J. Leon Diaz, (2002) Humanitarian Intervention Issues.

<sup>15</sup> K. Mills, (Qershor 2000) The legitimacy of humanitarian access and intervention.

<sup>16</sup> Schmitt, Michael N. "The use of force in International Law". The JAG Warrior, June 1999.

#### 4. Raste të ndërhyrjeve humanitare

Ndërhyrja humanitare, e cila nënkupton përdorimin e forcës në një shtet nga një shtet tjetër ose grup shtetesh që mund të përbëjnë një koalicion, me qëllimin e dhënies fund të një krize humanitare, pa lejen e shtetit ku do kryhet ndërhyrja,<sup>17</sup> është një prej koncepteve më të debatueshme në botën e politikës ndërkombëtare. Kjo për faktin se ideja e ndërhyrjes humanitare bie në kundërshtim me parimin e sovranitetit shtetëror. Megjithëse, ideja e ndërhyrjes humanitare është e vjetër, doktrina e ndërhyrjes humanitare ka tërhequr vëmendjen, veçanërisht pas ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, duke u konsideruar nga shumë ekspertë ligjor si një lloj i luftës së drejtë, pavarësisht debateve të shumta politike.

Në fund të viteve 1980, Profesor Mario Bettati dhe politikani francez Bernard Kushner përdorën për herë të parë termin e “të drejtës për të ndërhyrë”.<sup>18</sup> Ata kërkuan të drejtën për të ndërhyrë kur shtetet shtypin qytetarët e tyre, të shtyrë nga fakti i përdorimit të konceptit të sovranitetit shtetëror, si mbrojtje për shkeljet e të drejtave themelore njerëzore. Në vitet '90, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, ndoshta i çliruar nga frika e një Luftë të Tretë Botërore, komuniteti ndërkombëtar filloi të ndërmernte aksione të përbashkëta për mbrojtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, si dhe të të drejtave njerëzore.

Koncepti i “të drejtës për të ndërhyrë” në mbrojtje të të drejtave njerëzore u përdor nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për veprimin ushtarak që u ndërmor kundër Irakut nga vende të ndryshme perëndimore, në prill 1991. Ky operacion, i cili filloi si operacion i Shteteve të Bashkuara, u prezantua si një masë për të mbrojtur kurdët, të cilët po vdisnin në malet e mbuluara me borë të Irakut Verior.<sup>19</sup> Mbështetja e popullsisë refugjate kurde lart në male, ishte shumë e vështirë. Pas kundërshtimit të fuqishëm të Turqisë për të lejuar futjen e kurdëve në Turqi, forcat e koalicionit krijuan zonat e sigurta për kurdët në Irakun Verior. Ndërhyrja në Irak tregoi se të drejtat e njeriut tashmë do të ishin të detyrueshme për t'u zbatuar nëpërmjet veprimit të komunitetit ndërkombëtar.

Bazuar në të njëjtin koncept Këshilli i Sigurimit në vitin 1992 me rezolutën 794 (3 dhjetor 1992), autorizoi ndërhyrjen humanitare në Somali. Operacioni në Somali kishte si qëllim t'i jepte fund anarkisë dhe të krijonte kushtet në të cilat njerëzit mund të mbijetonin. Megjithëse, ky operacion nuk arriti të sillte paqe, ishte një sukses si përpjekje

<sup>17</sup> Hannes Peltonen, Right and Responsibility, What Kind of Right is the Right of Humanitarian Intervention? EUI Working Papers SPS No. 2006/03.

<sup>18</sup> Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention. Global Dialogue, Vol.7, Num. 1-2, Winter/Spring 2005.

<sup>19</sup> Benedikt F. Franke The use of sustained coercive air power in humanitarian interventions. Journal of Humanitarian Assistance 30 Dec 2004.

humanitare.<sup>20</sup> Ndërhyrja humanitare është autorizuar edhe me rezolutën 678 (29 nëntor 1990), e cila lejonte përdorimin e “të gjitha mjeteve të nevojshme” për çlirimin e Kuvajtit.<sup>21</sup> Shembull tjetër është rezoluta 929 e vitit 1994 (22 qershor 1994), e cila autorizonte forcat franceze për të përdorur “të gjitha mënyrat e nevojshme për të arritur objektivat ushtarake” në Ruanda. Kjo në fakt ishte një ndërhyrje e kufizuar, që u krye me vonesë dhe që lidhej me interesat franceze në Ruanda.

Konflikti në Bosnjë dhe Hercegovinë, i cili është konsideruar si një prej konflikteve më të përgjakshme në Evropë, që prej L2B ishte një tjetër rast që tregoi dobinë e përdorimit të forcës ushtarake për mbrojtjen e të drejtave njerëzore. “Spastrimi etnik” që u bë kundër myslimanëve në Bosnjë, mori fillimisht një përgjigje të heshtur.<sup>22</sup> Paqeruajtësit e Kombeve të Bashkuara që ishin vendosur për të siguruar shpërndarjen e ndihmës humanitare, kishin mandat shumë të kufizuar për të përdorimit të forcës. Kur serbët e Bosnjës sulmuan “zonën e sigurt” të Sarajevës dhe refuzuan kushtet e NATO-s e të Kombeve të Bashkuara për tërheqjen e armatimeve të rënda, Kombet e Bashkuara autorizuan NATO-n të ushtronte forcë të armatosur në kryerjen e misionit të saj në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ndërhyrja e NATO-s në Bosnjë ndryshoi rrjedhën e konfliktit, duke i çuar palët në nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit. Kjo tregoi se po të ishte përdorur forca 3 vjet më parë, kur filloi konflikti i Bosnjës, do kishte ndryshuar situata që në atë kohë.<sup>23</sup>

## 5. Ndërhyrja humanitare në Kosovë

Konflikti i hapur ndërmjet UÇK-së dhe forcave ushtarake e policore serbe në Kosovë në pranverë të vitit 1998, bëri që komuniteti ndërkombëtar të reagojë, sepse pasojat humanitare të konfliktit që përshkallëzohej ishin shumë të rënda dhe ekzistonte rreziku i përhapjes së konfliktit në vende të tjera. U kërkua që serbët t’i jepnin fund sulmeve kundër popullsisë civile. Përpjekje të shumta diplomatike u bënë për të bindur Milosheviçin që të tërhiqte forcat nga Kosova dhe të lejonte vendosjen e një prezence të NATO-s në Kosovë. Përpjekjet diplomatike u pasuan nga kërcënimi i NATO-s për goditje ajrore më 13 tetor 1998. Këto goditje nuk u zbatuan në atë kohë sepse vënë përballë kërcënimit për ndërhyrje ushtarake Milosheviçi pranoi të bashkëpunonte, duke premtuar dhënien fund dhunës dhe duke pranuar lejimin e kthimit të refugjatëve. Pas bisedimesh të gjata e të vështira ndërmjet të dërguarit të SHBA për Ballkanin, Richard Holdbrook, dhe Milosheviçit u arritën marrëveshjet e 15–18 tetorit 1998, të cilat sollën një tërheqje të pjesshme të forcave serbe të sigurisë nga Kosova dhe siguruan vendosjen e

<sup>20</sup> Major L.M.Martin, United States Marine Corps, Humanitarian Success And Political/Military Failure, <<http://www.globalsecurity.org/military/library/report/1995/MLM.htm>>.

<sup>21</sup> Schmitt, Michael N. “The Use of Force in International Law”. The JAG Warrior, June 1999.

<sup>22</sup> K. Mills, (June 2000) The legitimacy of humanitarian access and intervention.

<sup>23</sup> Joshua G. Smith, The Responsibility to reflect: Learning Lessons from Past Humanitarian Military Interventions, March 26, 2006 The Journal of Humanitarian Assistance.

monitoruesve të OSBE-së në Kosovë për të vëzhguar zbatimin e marrëveshjes në terren, si dhe u krijua misioni i survejimit ajror të NATOs.

Pavarësisht nga këto marrëveshje të përkohshme, konflikti mes UÇK-së dhe forcave serbe si dhe reprezaljet e këtyre të fundit ndaj popullsisë civile vazhduan gjatë dimrit të vitit 1998 dhe fillimit të vitit 1999. Situata u përkeqësua në fillim të vitit 1999, kur autoritetet serbe vunë në veprim një numër të madh forcash ushtarake dhe policore. Më 15 janar të vitit 1999 u vranë 45 shqiptarë etnikë në fshatin Raçak, 18 milje në jug-perëndim të Prishtinës. Kjo masakër u konsiderua nga vendet perëndimore dhe Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si simboli i shkeljes së marrëveshjes së tetorit 1998. Në 29 janar, në Londër, ish sekretarja amerikane e shtetit Madlin Albright, e cila drejtoi procesin diplomatik që përfundimisht rezultoi në ndërhyrjen ushtarake kundër forcave të Milosheviçit në mars të vitit 1999, deklaroi publikisht mbajtjen e konferencës në Rambuje të Francës, më 6 shkurt 1999.<sup>24</sup> Në 18 mars 1999, delegacioni shqiptar, amerikan dhe britanik nënshkruan marrëveshjen e Rambujesë, ndërsa delegacioni serb dhe rus refuzuan. Pas kësaj ngjarjeje eksodi masiv i popullsisë së Kosovës drejt Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi rifilloi për shkak të futjes së trupave dhe armatimeve të tjera serbe në Kosovë.

Çështja e Kosovës u bë objekt diskutimi edhe në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kur u intensifikua konflikti në Kosovë në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999, Këshilli i Sigurimit adoptoi disa rezoluta në të cilat shprehej shqetësimi i thellë për dhunimet e të drejtave njerëzore dhe kërkohej ndalimi i këtyre shkeljeve dhe i përdorimit të dhunës.<sup>25</sup> Reagimi i Këshillit të Sigurimit ndaj shkeljes së të drejtave njerëzore në Kosovë tregoi që Këshilli i Sigurimit është një organ që njeh dhe mbron të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe e konsideron respektimin e këtyre të drejtave si kusht të domosdoshëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë botërore. Megjithatë, Këshilli i Sigurimit nuk autorizoi përdorimin e forcës për zgjidhjen e konfliktit, për shkak të refuzimit të dy prej anëtarëve të tij të përhershëm, Rusisë dhe Kinës. Pas shumë përpjekjesh të dështuara diplomatike për të bindur presidentin Millosheviç që të tërhiqej, presidenti Clinton deklaroi publikisht: “Me diktatorët e Ballkanit, nëse heziton u jep atyre liçencën për të vrarë”.<sup>26</sup> Në mbrëmjen e 23 marsit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Javier Solana urdhëroi Gjeneralin Klark të nisë operacionet ushtarake.

Veprimet e NATO-s kundër Jugosllavisë shkaktuan reagime të ndryshme. Legjitimiteti i fushatës bombarduese të NATO-s u bë objekt i shumë debateve. Ajo u pa nga disa si

<sup>24</sup> Medllin Ollbrajt dhe Lidërshipi nga Kosova, Politika Shqiptare, 2006.

<sup>25</sup> Noelle Quenivet, (2000) Humanitarian assistance: a right or a policy? Case study: the Security Council and the armed conflict in the former Yugoslavia.

<sup>26</sup> Medllin Ollbrajt dhe Lidërshipi nga Kosova, Politika Shqiptare, 2006.

ndërhyrje e paligjshme, agresion i armatosur, cënim i tërësisë territoriale dhe sovranitetit shtetëror duke qenë se Kosova ishte brenda hartës politike të Serbisë. Argumentet që u përdorën për të kritikuar ndërhyrjen ishin të shumta. Sipas kundërshtarëve të ndërhyrjes humanitare në Kosovë, neni 2(4) i Kartës së Kombeve të Bashkuara, ndalon ndërhyrjet ushtarake në vendet e tjera sovraane. Sipas tyre, edhe në qoftë se ndonjëherë kishte ekzistuar një e drejtë e ndërhyrjes së paautorizuar, ajo ishte shuar që nga hartimi i Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ndërhyrjet në shtetet sovraane lejohen vetëm kur atë e vendos Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara. Ky ishte argumenti që u përdor veçanërisht nga Kina dhe Rusia, të cilat u përpoqën të argumentonin se përdorimi i forcës ndaj Jugosllavisë do të përbënte një shkelje të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Një tjetër argument që u përdor nga ata që nuk janë në favor të ndërhyrjes humanitare të paautorizuar nga Këshilli i Sigurimit ishte se NATO nuk kishte të drejtë të ndërhynte pa siguruar më parë autorizimin e Këshillit të Sigurimit. NATO është një organizatë e krijuar për mbrojtjen e anëtarëve të saj, kur ata bëhen objekt i ndonjë sulmi. Në rastin e konfliktit të Kosovës nuk kërcënohej drejtpërdrejt ndonjë shtet anëtar i NATOs. Veprimet e NATOs nuk u legalizuan nga Këshilli i Sigurimit sepse përdorimet e lejueshme të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare, sipas Kartës së Kombeve të Bashkuara nuk i justifikonin ligjërisht aksionet e NATOs. Kritikët e ndërhyrjes së NATOs në Kosovë pretenduan se bombardimi i NATOs përshpejtoi dhe ashpërsoi “spastrimin etnik”, që ishte planifikuar nga Milosheviçi, por që nuk kishte filluar të zbatohet. Sipas tyre lufta dhe urrejtja që ajo shkaktoi siguruan kushtet për kryerjen e mizorive masive.

Ndërhyrja e NATOs në një vend sovran kundër udhëheqjes së tij, megjithëse nuk gjeti një mbështetje ligjore krejt të saktë, u justifikua ligjërisht nga ajo pjesë e njerëzve që nuk pranuan ta konsideronin ndërhyrjen humanitare në Kosovë si shkelje të së drejtës ndërkombëtare.<sup>27</sup> Ndërhyrja ushtarake në Kosovë në mars 1999 përfaqëson një përdorim të suksesshëm të forcës ndërkombëtare për t'i thënë “ndal” abuzimit me të drejtat njerëzore dhe për t'i dhënë fund krimeve kundër njerëzimit, të kryera nga një shtet brenda kufijve të tij. Mediatori amerikan Richard Holbrooke e quajti veprimin e NATOs si një precedent. “Rasti i parë në histori që një organizatë ushtarake i njohu vetes të drejtën e ndërhyrjes në një vend sovran kundër udhëheqjes së tij.” Drejtuesit politikë të shteteve perëndimore pretenduan se ata kishin një përgjegjësi morale për të ndaluar barbarizmat e tmerrshme që po kryheshin në Kosovë. Në kohën kur filloi bombardimi Sekretari i Përgjithshëm i NATOs, Javier Solana justifikoi ndërhyrjen duke thënë: “Ne duhet të ndalojmë dhunën dhe t'i japim fund katastrofës humanitare që tani po shpaloet në Kosovë. Ne kemi një detyrë morale për të vepruar kështu. Përgjegjësia është e jona dhe ne do ta përmbushim atë.”

<sup>27</sup> Noelle Quenivet, (2000) Humanitarian assistance: a right or a policy? Case study: the Security Council and the armed conflict in the former Yugoslavia.



Në mbështetje të ligjshmërisë së veprimit ushtarak të NATO-s në Kosovë, presidenti Bill Clinton dhe kryeministri Toni Bler në fjalimet e tyre kryesore për luftën argumentuan se situata në Kosovë përbënte një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Ata theksuan se numri i madh i refugjatëve që largoheshin nga Kosova mund të krijonte destabilizim në vendet fqinjë dhe të çonte në një zgjerim të luftës. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s i dha fund spastrimit etnik që autoritetet serbe po zbatonin ndaj shqiptarëve të Kosovës brenda kufijve të shtetit të tyre. Ajo ishte legjitime edhe pse nuk siguroi autorizimin e Këshillit të Sigurimit, sepse u përdor pas shterimit të të gjitha mjeteve diplomatike ndërkombëtare dhe çliroi popullsinë e Kosovës nga shtypja serbe.<sup>28</sup> Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë lëkundti konceptin e sovranitetit shtetëror dhe rriti vlerësimin ndërkombëtar për të drejtat njerëzore.

## 6. Çështje të ndërhyrjes humanitare

Shkeljet masive dhe sistematike të drejtave të njeriut duhen kontrolluar jo vetëm se ato mund të shkaktojnë rreziqe për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, por edhe për faktin se është detyrim njerëzor mbrojtja e individëve të dhunuar. Në situata krizash të rënda humanitare, që bëjnë të domosdoshëm përdorimin e ndërhyrjes ushtarake për qëllime humanitare, duhen bërë përpjekje që shkeljet e të drejtave të njeriut dhe vuajtjet e popullsisë të mos shtohen. Duhet siguruar pra, që ndërhyrja të ketë efekte pozitive më shumë se negative dhe të ndikojë në përmirësimin e situatës humanitare. Shkeljet e të drejtave të njeriut, që ndodhin në vende të ndryshme duhet të vlerësohen nga komuniteti ndërkombëtar në mënyrë të barabartë me qëllim që të mos krijohet ideja se të drejtat e disa popujve janë më të rëndësishme se të disa të tjerëve.<sup>29</sup> Megjithatë, në qoftë se një situatë e caktuar justifikon përdorimin e forcës ndërkombëtare nuk do ishte e drejtë të pretendohet për mosndërhyrje në mbrojtje të të drejtave njerëzore thjesht për faktin se barbarizma të tjera u neglizhuan më parë. Çështja është që ndërhyrja të inkurajohet në të gjitha vendet ku është e nevojshme dhe jo t'i mohohet njërit vend për shkak se nuk është ndërhyrë më parë në tjetrin.<sup>30</sup>

Një tjetër kërkesë e domosdoshme lidhur me ndërhyrjet humanitare është që shtetet që ndërhyjnë nuk duhet të kenë motive të tjera politike dhe ekonomike përveç atyre humanitare për të realizuar ndërhyrjen. Megjithatë është pranuar që gjetja e arsyeve thjesht humanitare është e vështirë. Ndërhyrjet e zhvilluara vitet e fundit kanë treguar se kanë ekzistuar edhe motive të tjera përveç atyre humanitare, si psh nevoja për pengimin e

<sup>28</sup> Hannes Peltonen, Right and Responsibility, What Kind of Right is the Right of Humanitarian Intervention? EUI Working Papers SPS No. 2006/03.

<sup>29</sup> Penelope C. Simons, (2000) Humanitarian Intervention: A Review of Literature. The Ploughshares Monitor. December 2000, volume 21, No.4.

<sup>30</sup> Ken Roth, (2004) War in Iraq: Not a Humanitarian Intervention.

fluksit të refugjatëve ose interesat strategjike dhe ekonomike në shtetin ku ndërhyhet. Zhvillimi i ndërhyrjeve humanitare me qëllimin e dhënies fund të shkeljeve masive dhe sistematike të të drejtave njerëzore është i domosdoshëm, në rastet kur përdorimi i forcës mbetet opsioni i fundit i arsyeshëm dhe Këshilli i Sigurimit nuk është në gjendje të veprojë.

Komisioni Ndërkombëtar mbi Ndërhyrjen dhe Sovranitetin Shtetëror, i ngritur nga qeveria kanadeze në shtator 2000, publikoi në dhjetor 2001 raportin “Përgjegjësia për të Mbrojtur”. Në këtë raport u theksua idea e sovranitetit si përgjegjësi dhe u nënvizua përgjegjësia e komunitetit ndërkombëtar për të reaguar ndaj krizave me mjete diplomatike dhe masa shtrënguese, duke përdorur ndërhyrjet ushtarake si mjet të fundit. Ndërhyrja mbi baza humanitare pa pëlqimin e qeverisë së vendit ku do kryhet ndërhyrja duhet përdorur me shumë kujdes, sepse ekziston rreziku që forca të përdoret për interesa vetjake, duke përdorur arsyet humanitare vetëm si justifikim për veprimin ushtarak.

Përdorimi i forcës jashtë sistemit të Kombeve të Bashkuara mund të krijojë mundësinë e abuzimit me konceptin e ndërhyrjes, duke vendosur precedentë të rrezikshëm ndërhyrjesh, të zhvilluara pa kritere të përcaktuara qartë dhe mund të rrezikojë kështu sistemin e sigurisë të krijuar pas Luftës së Dytë Botërore. Mund të kujtojmë se në vitin 1939 Gjermania naziste përdori arsyet humanitare për të legjitimuar pushtimin e Çekosllovakisë, duke deklaruar se gjermanët etnikë po keqtrajtoheshin në Sudetenland.<sup>31</sup>

## 7. Konkluzione

Nisur nga fakti se paqja është e domosdoshme për gëzimin e të drejtave të njeriut dhe se shkelja e këtyre të drejtave mund të kërcënojë seriozisht paqen ndërkombëtare, mund të themi se është me rëndësi të madhe arritja e një konsensusi ndërkombëtar në drejtim të parandalimit të barbarizmave masive që shkaktojnë kriza humanitare. Duke qenë se lufta përmban në vetvete rrezikun për jetën dhe në disa raste mund të shkaktojë fatkeqësi të tjera, forca ushtarake duhet të jetë opsioni i fundit që mund të përdoret për qëllime humanitare. Shkeljet e rënda që kryhen në kurriz të një popullsie duhet të përballen fillimisht me alternativa paqësore, si presion publik, ndjekje penale për personat përgjegjës, sanksione ekonomike dhe diplomatike. Për të shmangur rrezikun e abuzimit me përdorimin e forcës nga ana e shteteve më të fuqishme dhe me qëllim që ndërhyrjet humanitare të jenë të ligjshme e të kufizohen vetëm në përmbushjen e misionit të tyre fisnik të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, duhet të kristalizohet një rregull i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare, i cili të lejojë përdorimin e forcës së armatosur.

---

<sup>31</sup> Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention. Global Dialogue, Vol.7, Num. 1-2, Winter/Spring 2005.

Krijimi i një kornize ligjore brenda të cilës të mund të vendoseshin ndërhyrjet humanitare, do t'i siguronte komunitetit ndërkombëtar një bazë ligjore mbi të cilën të vepronte me qëllim që t'i japë fund barbarizmave e krimeve kundër njerëzimit, të cilat përbëjnë kërcënim për paqen. Këtu do të përfshihej përcaktimi i qartë i situatave dhe i shkeljeve që e bëjnë të domosdoshme ndërhyrjen ushtarake për ndalimin e shkeljeve masive të drejtave të njeriut. Përcaktimi i mënyrës së marrjes së vendimit që përfshin caktimin e organizmit që do ketë të drejtë të marrë vendimin për fillimin e ndërhyrjes në mënyrë që të shmanget mundësia e ndërhyrjes për motive të ndryshme nga ato humanitare. Me rëndësi do të ishte edhe përcaktimi i kohës së marrjes së vendimit dhe kohëzgjatjes së përdorimit të forcës, në mënyrë që të mos kapërcehet qëllimi i ndërhyrjes që është vetëm rivendosja e respektit për të drejtat e njeriut.

## BIBLIOGRAFIA

- Albrecht Schnabel and Ramesh Thakur, (2000) Kosovo and the Challenge of Humanitarian Intervention: Selective Indignation, Collective Intervention, and International Citizenship.
- Benedikt F. Franke The use of sustained coercive air power in humanitarian interventions. *Journal of Humanitarian Assistance* 30 Dec 2004
- Charter of the United Nations, June 26, 1945, entered into force October 24, 1945.
- Chris Abbott, Rights and Responsibilities. Resolving the Dilemma of Humanitarian Intervention. *Global Dialogue*, Vol.7, Num.1-2, Winter/Spring 2005.
- F. J. Leon Diaz, (2002) Humanitarian Intervention Issues.
- Hannes Peltonen, Right and Responsibility, What Kind of Right is the Right of Humanitarian Intervention? *EUI Working Papers SPS No. 2006/03*.
- Hugo Slim, (June 2000) Military humanitarianism and the new peace keeping. An agenda for peace?
- Jonathan I. Charney, Anticipatory Humanitarian Intervention in Kosovo. *Vanderbilt Journal of Transnational Law*, November 1999.
- Joshua G. Smith, The Responsibility to reflect: Learning Lessons from Past Humanitarian Military Interventions, March 26, 2006 *The Journal of Humanitarian Assistance*.
- K. Mills, (June 2000), The legitimacy of humanitarian access and intervention.
- Ken Roth, (2004) War in Iraq: Not a Humanitarian Intervention.
- Larry Minear, Ted van Baarda, and Marc Sommers, NATO and Humanitarian Action in the Kosovo Crisis. *Watson Institute* 2000.
- Medllin Ollbrajt dhe Lidershipi nga Kosova, *Politika Shqiptare*, 2006
- Michelle Maiese, (2003) Human Rights Violations.
- Michelle Maiese, (2004) Human Rights Protection.
- Noelle Quenivet, (2000) Humanitarian assistance: a right or a policy? Case study: the Security Council and the armed conflict in the former Yugoslavia.
- Oliver Corten, Humanitarian intervention: a controversial right, June 1999.
- Penelope C. Simons, (2000) Humanitarian Intervention: A Review of Literature. *The Ploughshares Monitor*. December 2000, volume 21, No.4.
- Schmitt, Michael N. "The use of force in International Law". *The JAG Warrior*, June 1999.
- Stefan Kirchner, The Human Rights Dimensions of International Peace and Security: Humanitarian Intervention after 9/11. *Journal of Humanitarian Assistance*, 25 October 2004.

*Burime në internet:*

Annan, Kofi 1999, "Two Concepts of Sovereignty", The Economist, 18 September,  
[www.un.org/Overview/SG/kaecon.htm](http://www.un.org/Overview/SG/kaecon.htm)

Independent International Commission on Kosovo, The Kosovo Report: Conflict  
International Responses, Lessons Learned (Oxford: Oxford University Press, 2000)

Kosovo Liberation Army, March 2008,

[http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo\\_liberation\\_Army](http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_liberation_Army)

Kosovo War, [http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo\\_War](http://en.wikipedia.org/wiki/Kosovo_War) April 2008

Major L.M.Martin, United States Marine Corps, Humanitarian Success And  
Political/Military Failure,

<http://www.globalsecurity.org/military/library/report/1995/MLM.htm>

Milena Sterio, The Kosovar Declaration of Independence: "Botching the Balkans" or  
Respecting International Law?, Georgia Journal of International and Comparative Law,  
Forthcoming, Cleveland-Marshall Legal Studies, 21 Sep.2008

NATO's role in relation to the conflict in Kosovo,

<http://www.nato.int/kosovo/history.htm>

"Platforma amerikane ne paralelizmat negative te diplomacies,

<http://www.vendlindja.com/forum/showthread.php>

United Nations Security Council Maintaining Peace and Security: Humanitarian aspects  
of Issues before the Security Council (S/PV. 4109/2000).

**THE INTERNATIONAL RESPONSIBILITY WITH REGARD TO THE  
PROTECTION OF HUMAN RIGHTS**

**Abstract:** In contemporary international law respect for human rights is considered as a condition for maintaining international peace and security. The obligation to ensure respect for human rights rests primarily with every sovereign state. Nevertheless, the situation of human rights in a country remains an issue of interest to the international community as a whole. The international community cannot simply stand by idly, while human rights violations take place in a country. When the civilian population suffers from serious human rights abuses, either because the government fails to prevent them, or because it carries out such criminal acts itself, the responsibility for their protection passes on to the international community.

The international community must make use of all available means to ensure human rights are respected in all countries, since massive and systematic violations of these rights may represent a threat against peace. Such violations initially have to be confronted through peaceful alternatives i.e. public pressure, legal actions against responsible individuals, economical and diplomatic sanctions. Achieving an international consensus to prevent or put an end to mass atrocities which cause humanitarian crisis, is of great importance. While in some cases the scale of human rights abuse has been such that use of force was seen as the only possibility to bring to such a situation, military force must be the last resort to be used in humanitarian crises.

**Keywords:** Humanitarian intervention, international community, humanitarian crisis, international security system, state sovereignty, human rights.